



EDITORIAL

MUJI TETOR - MUJ I RRUZARËS SË SHENJTË

Muaj tetor, I kushtohet përsëritërisë së lutjes së Rruzares së shenjtë, lutjes që Virgjëra Mari aq shumë e këshillon gjatë shekujve dhe e kërkon nga besimtarët në shfaqjet e veta.

Përsëritëria e muajt tetor lindi në çastin kur Perandoria Turke i kërcënohej Evropës. Lutjen e Rruzares e kërkoj Ati i shenjtë Piu V në vitin 1571 nga të gjithë të krishterët. Siç dëshmojnë dokumentet historike, populli iu përgjigji Papës me bujari, kështu që me ndërmjetësimin e Zojës së Bekuar ushtria e krishterë korri fitore në betejën detare të Lepantit në vitin 1571. Mirëpo lutja e Rruzares së shenjtë lindi edhe për shkak të nevojës së zemrës që të meditoj misteret e Jetës së Zotit tonë Jezu Krishtit.

Lutjen "Të falemi Mari" e përcjellin misteret e Rruzares, kërkesa e zemrës, sepse përsëritja nuk është shenjë e mërzisë, por e gëzimit që kemi mundësi të lutemi aq bukur me Nënë, duke i medituuar së bashku me Marinë Misteret e jetës së Jezusit të cilat ajo i njohi më së miri.

Për rolin e Marisë në misterin e shëlbimit na flet në dy vende Ungjilli i Shën Gjonit. Së pari - në Dasmën e Kanës së Galileës, kur Maria pa nevojën e madhe, sepse në dasmë filloj të mungojë vera, ndërmjetësoj tek Biri, për të cilin e dinte se ishte Hyj që e kërkon bashkëpunimin tonë, duke ju thënë shërbëtorëve: "Bëni gjithçka t'ju thotë!" Kjo është lutja e besimit. Maria është ajo që na amëson si ta kemi marrëdhënien me Hyjin. Së dyti - kur Jezusi në mesin e historisë së urrejtjes njerëzore e vendos dashurin e pafund të Hyjit, d.m.th. në çastin kur vepra e dashurisë së pafund hyn si vepër konkrete në historinë njerëzore, atëherë Jezusi i tha Marisë: 'Grua, ja yt bir, ja vajza e jote. Unë ty të dhuroj njerëzve. Të dhuroj atyre, që amësia jote të bëhet mjet dashurie që të kesh mundësi t'i edukosh në dashuri, ashtu siç jetove Ti.'

Të dashur miq, të marrim vendim që të bashkohemi çdo ditë gjatë këtij muaj që ta lusim Rruzaren e shenjtë, në kishë, tek kryqet e ndryshme, në sheshe, në familje, në rrugë, në çastet e lira që kemi, duke pritur, në punë...

Rruzarja në duart e të krishterëve është armë e fortë kundër Djallit dhe shpirttrave të këqij, sepse më lutje të Rruzares, në bisedë me Hyjin e Gjallë dhe Nënë tonë, mbështillemi me petkun e dritës dhe të Mëshirës së Hyjit. Na hapen sytë për të parë nevojat e vërteta tonat dhe të tjerëve, i kujtojmë fëmijët e palindur, ata që vuajnë në çfarëdo mënyre, të sëmurit, njerëzit në vështirësi, të gjithë ata që i skllavëroi alkooli, droga, sharjet, jeta flligështare. Të lutemi me guxim dhe krenarinë e njerëzve që nuk kanë frikë të përgjigjen në thirrjen e Hyjit duke qenë të qëndrueshëm dhe të pathyeshëm në udhën e Tij, udhën e përvujtërisë dhe të dorëzimit të plotë të njerëzve që jetojnë jetën që Hyji e kërkon prej tyre. Ta kujtojmë Kishën, Papën, ipeshkvijtë, meshtarët, rregulltarët dhe rregulltarët dhe të gjithë besimtarët, T'i kujtojmë të rinjtë, familjet, të vjetrit... që të jenë në gëzim në situatat jetësore dhe të hapur për jetën. Të lutemi për shoqërinë e sotme dhe situatat e ndryshme të shoqësisë sonë dhe botës, që të nderohet dinjiteti dhe e drjta e njeriut, që të jemi solidar me ata që nuk kanë duke i kuptuar dhe duke i ndihmuar sinqerisht me të gjitha të mirat që zotërojmë. Të lutemi që të jemi të kujdesshëm në ruajtje të natyrës, ta sodisim dhe ta dallojmë bukurinë e saj për ta bërë edhe më të bukur aty ku jetojmë.



Të lutemi në përvujtëri, më fe dhe shpresë në zemër sepse Jezusi thotë: "Kërkoni e do të gjeni! Lypni e do tu jepet! Trokitni e do tu çelet!" Jakobi apostull na kujton: "Nuk keni, sepse nuk kërkoni. Kërkoni e nuk merrni, sepse kërkoni keq: që të përfundoni në epshet tuaja", por ai gjithashtu na nxiti: "Nënshtroju, pra Hyjit! Kundërshtoni djallit dhe do të largohet prej jush! Afrojuni Hyjit dhe ai do të afrohet tek ju! Pastroni duart, mëkatar! Patroni zemrat, o njerëz dyfyturësh! Qani, ankohuni. Buzëqeshja juaj le të kthehet në vaj e gëzimi në hidhërim! Përvujtërohuni para Zotit dhe ai do tu lartësoj!" Kështu muaj tetor do të jetë muaj i bekimeve që Zoja rruzare i ka rezervuar për ne dhe për ata për të cilët këtë muaj do ta kushtojmë.

Don Preka

Në këtë numër do të lexoni:

- Të gjithë të bashkuar në emër të Marisë
- Radio Maria me Papën për paqë
- Nga Mariatona... në Mariatonë
- Dëgjuesit për Radio Marinë

- fq. 2
- fq. 2
- fq. 3
- fq. 4

TË GJITHË TË BASHKUAR NË EMËR TË MARISË

Më 12 dhe 13 tetor "Dita Mariane", ngjarje e përfshirë në kalendarin e Vitit të Fesë.

Më 12 dhe 13 tetor 2013, në Sheshin e Shën Pjetrit në Romë, pritet të vijë me mijëra shtegtarë. Grupe që do të vijë nga të gjitha anët e botës për të marrë pjesë në ngjarjen e vetme MARIANE të përfshirë në programin e Vitit të Fesë. Radio Maria do ta përcjell këtë ngjarje kaq të rëndësishme për Kishën në përgjithësi. Grupet e para pritet të arrijnë në Romë që nga e shtuna në mëngjes. Shtegtaret deri në orën 12 do të kenë mundësi të vizitojnë varrin e Shën Pjetrit, ndërsa në të gjitha



kishat afër Vatikanit do të bëhet adhurimi eukaristik dhe do të kenë mundësi që të rrëfihen. Pasdite parashihet pranimi i trupores origjinale të Zojës Fatima në shesh dhe pastaj do të jetë katekeza. Në mbrëmje të gjithë shtegtarët do të shkojnë në shenjtëroren "Divino Amore", në të cilin do të jetë një çast lutjeje: "Me Marinë përtej natës" që parashikon një Rruzare në shumë gjuhë me anë të së cilës do të lidhen të gjitha shenjtëoret mariane në mbarë botën.

Pika qendrore e kremtimit do të jetë të dielën më 13 tetor me Meshën e shenjtë në Sheshin e Shën Pjetrit që do ta kremtojë Ati i shenjtë, Françesku.

Ngjarja është pjesë e ngjarjeve që kremtohen me rastin e Vitit të fesë. Radio Maria ishte dëshmitare e privilegjuar kësaj ngjarjeje, sepse ishte pjesë e grupit të punës në përgatitjen e programit të kësaj ngjarjeje mariane.

Deri me tani, Këshilli panor për Ungjillëzimin e ri ka evidentuar pothuajse 6 milion shtegtarë që kanë vizituar Romën me rastin e Vitit të Fesë. Ky numër do të rritet falë ngjarjeve të ardhshme që do të zhvillohen: Dita e Familjes 26 dhe 27 tetor dhe Kremtimi i mbylljes së Vitit të Fesë që do të bëhet më 24 nëntor 2013.

Daniele Trencia

RADIO MARIA ME PAPËN PËR PAQE

Njëra nga shtyllat që e bëjnë të dallueshme Radio Marinë në identitetin e saj është besnikëria ndaj Magjisterit që konkretizohet jo vetëm në drejtimin editorial, por edhe në qëndrimin e veçantë dhe kujdesin me të cilin ngjarjet e rëndësishme kishtare ju ofrohen dëgjuesve të saj, duke iu mundësuar që të jenë të bashkuar me Atin e shenjtë në secilin cep të botës. Kjo gjë ndodhi edhe gjatë lutjes së mbrëmjes që Ati i shenjtë, Françesku, përball ngjarjeve tragjike dhe skenave të dukshme të konfliktit në Siri vendosi të përgjigjet me armë shumë më të forta: me lutje dhe agjërime.

Në thirrjen dramatike që e bëri gjatë lutjes Engjëlli i Hyjit më 1 shtator Papa, Françesku dëshiroj të bëhet "interpretues i klithjes që ngrihet nga çdo pjesë e Tokës, nga çdo popull, nga zemra e secilit, nga familja e vetme e madhe e njerëzimit, më frikë në rritje: është klithja për paqe!" Dita e 7 shtatorit, që e zgjodhi Papa që është nata e të Kremtes së Lindjes së Virgjërës Mari (që Papa gjithnjë e më shumë e quan Mbretëreshë të Paqes, titull që veçanërisht i pëlqen) nxiti kështu një mobilizim botëror të lutjes dhe agjërimit që pikën qendrore e pati në sheshin e Shën Pjetrit në Romë.

Më shumë se katër orë lutje që i vulosi Rruzarja e shenjtë, Adhurimi Eukaristik, Shërbesa e leximeve që të "ndërtoheshin marrëdhëniet e bashkëjetesës dhe të drejtësisë në dashuri" - siç nxiste i Lumi Gjoni XXIII, në rastet njëjtë tragjike. Familja botërore e Radio Marisë, nuk kishte mundësi të mungonte në



këtë mobilizim për paqe, duke dhënë kontributin e vet përmes valëve të radios, duke i bashkuar pesë kontinentet nën shikimin e Marisë dhe nën drejtimin e Pasardhësit të Pjetrit që i ftoj të gjithë për të shikuar Kryqin: "Aty mund të lexohet përgjigja e Hyjit: aty, në dhunë Ai nuk u përgjigj me dhunë, në vdekje nuk u përgjigj me gjuhën e vdekjes. Në heshtjen e Kryqit hesht edhe ushtria e armëve dhe flet gjuha e pajtimit, të faljes, të dialogu dhe të paqes".

Stefano Chiapalone



U N Ë J A M M E

M A R I A T H O N

«Ta ndihmojmë Zojën që të na ndihmojë»

www.mariathon.org

NGA MARIATONA... NË MARIATONË

Shpallja e Mariatonës 2014 që do të mbahet më 9, 10 dhe 11 maj 2014

Kur lind një ide e mirë, menjëherë pas zhvillohen të tjerat. Ky parim lindi në ngjarjen botërore të Mariatonës, që u realizua nga 8 deri më 12 maj të këtij viti, tek ne në Shqipëri nga 1 deri më 31 maj, e që bashkoj Familjen botërore të Radio Marisë. Mariatona 2013 ishte përvojë botërore, duke na zbuluar simfoninë në të cilën radiot, vullnetarët dhe dëgjuesit morën pjesë më dhjetëra mijëra për të realizuar projektin e madh misionar... ishte një përvojë e madhe, që na përfshiu dhe përmalloj, që e solli edhe një kontribut të rëndësishëm të bashkimit shpirtëror të Familjes sonë botërore të Radio Marisë.

Tani që kemi përvojë më shumë dhe që e njohim madhërinë e kësaj ngjarjeje botërore, jemi të gatshëm për tu nisur, duke e shpallur Mariatonën tjetër botërore që do ta kremtojmë më 9-10-11 maj 2014, që të bëjmë një hap tjetër përpara në realizimin e projektit që ta sellim Radio Marinë në ato vende në të cilat Radio Maria nuk është ende.

Ruga siç e dimë, është shumë e gjatë për ta realizuar qëllimin, sepse duhet mbledhur fondet për të mbështetur hapjen e 11 projekteve të reja të Radio Marisë në harkun tre vjeçar.

Këtu po bëjmë një përmbledhje të shkurtër të numrave të Mariatonës 2013 që dëshirojmë të bashkëndajmë me ju. Në këtë ngjarje morën pjesë më shumë se 60 vende të botës, duke përfshirë dhjetëra mijëra vullnetarë dhe dëgjues më qindra mijëra dëgjues, të cilët dhuruan 1000.000 euro, Radio Maria Shqiptare mori pjesë më 42000\$, për të realizuar pjesën e parë të projektit të madh që të fillojë Radio Maria në 11 vende që më kohë presin për të marrë këtë dhuratë të madhe. Mirësia e kësaj ngjarjeje dhe dashuria vëllazërore ishte edhe më e dukshme në gëzimin që e përjetuam duke marrë porosinë e urimit që na bëri personalisht Ati i shenjtë, Françesku, të shtunën më 11 maj 2013 (keni mundësi ta dëgjoni në kanalën youtube të FBRM: <http://www.youtube.com/user/WORLDFAMILYRM>).

Ja në mënyrë sintetike çfarë u bë e dukshme në Mariatonën 2013.

Çfarë vlerësoi më shumë Radio Maria?

- Shpirtin Misionar të ngjarjes.
- Njësinë botërore të Radio Marisë.
- Marinë, që u përfshi në një familje të madhe me qëllimin e vetëm të paqes dhe të fesë.
- Entuziazmi i dëgjuesve.
- Çastet që i jetuam së bashku me Radio Maritë në botë.
- Puna që bëmë së bashku me Radio Maritë e tjera.

Cilat janë sugjerimet parësore për Mariatonën 2014?

- Të fillojmë shumë shpejt me organizimin e ngjarjes.
 - Të japim mundësi që Mariatona të organizohet në data të ndryshme për shkak të ngjarjeve tjera të mundshme në vendet e ndryshme që nuk mund të lëvizin.
 - Të fillojmë me bashkëndarjet e thjeshta dhe të qarta që ndihmojnë ngjarjen e planifikuar.
 - Tu sugjerohet Radiove një rrjet programi për ditët e Mariatonës.
 - Të rriten çastet e lidhjeve botërore.
 - Bashkëpunëtorëve të Radiove që më parë tu ofrohet mundësia e formimit që kërkohet për të qëndruar në mikrofon gjatë kësaj ngjarjeje për të sensibilizuar dëgjuesit për të dhuruar.
 - Të realizohen përmbajtjet streaming që t'i kenë në dispozicion radiot, sidomos ndërhyrjet e Atë Livios dhe Emanuele Ferrarios, që radiot të kenë mundësi t'i përdorin.
 - Të kemi që më parë përcaktimet administrative dhe objektivat e mbledhjes së dhuratave.
 - Të përmirësohet ndihma teknike e lidhjeve botërore dhe kontinentale.
 - Të kemi në dispozicion fotografitë dhe materialet tjera që paraqesin zhvillimin e ngritjes së projekteve që i mbështet Mariatona.
- Kërkojmë lutjen dhe angazhimin tuaj më të madh për ta vazhduar realizimin e këtij misioni kaq të rëndësishëm.

Stafi i Familjes Botërore të Radio Marisë

Lajmëtari i Radio Marisë
është organ i
Shoqatës Radio Maria.

Tiranë

Rr. Papa Gjon Pali II, Nr. 4
Fushë Kërçik, Babrru, Paskuqan
Tiranë, Shqipëri
+355 4 2 346 346

Shkodër

Sheshi Papa Gjon Pali II
Shkodër, Shqipëri
+355 22 24 08 52

Lezhë

Sheshi Besëlidhja
Lezhë, Shqipëri
+355 215 24 970

E-mail: info@alb.radiomaria.org

Facebook: Radio Maria Albania

Përgjegjës: Don Prekë Lazraj

Radio Maria,
Hiri i Hyjit në shtëpinë tënde,
mund të dëgjohet në:

Rrëshen e rrethina

FM 100.7 MHz

Tiranë, Durrës, Kavajë, Berat

FM 91.4 MHz

Shkodër, Podgoricë, Ulqin

FM 102.2 MHz

Lezhë, Laç të Kurbinut, Mamurras

FM 89.6 MHz

Pukë, Fushë Arrëz, Tropojë,

Kukës dhe Kosovë

FM 90.0 MHz

në internet

www.radiomaria.al

DËGJUESIT PËR RADIO MARINË

Diella

Falënderoj Zotin për ju Don Prekë që të ka dhënë dhuratë në Radio Mari për ne, për të predikuar me kaq zjarr për të na e futur në zemrat tona Jezu Krishtin. Falënderoj Zotin shumë dhe e lus Lajmi i gëzueshëm të arrij në të gjithë veshët dhe zemrat e njerëzimit. Falënderojmë Zotin për të gjitha të mirat dhe të vështirat me të cilat rritemi në fe dhe na afrojnë me Zotin.

Bora

Falënderoj Zotin dhe ju për punën që bëni për ne në Radio Mari që është ngushëllimi i zemrave tona në çdo çast.

Lena

Falënderoj Zotin për Radio Marinë, për Kryqin e vetmisë që ma ka dhënë. Falënderoj Zotin për Radio Marinë që më ka mësuar që ta kuptoj dhe ta pranoj këtë Kryq. Kam menduar se jam e vetmuar por nuk është ashtu, Radio Maria dhe dëgjuesit e saj janë me mua. Do të shkoj pranë Kryqit e do të lutem gjithmonë, vazhdimisht.

Frroku

Së bashku me Jezusin e kam kaluar çdo vështirësi që më ka ardhur në jetë. Don Prekë mbaj mend kur jam rrëfyer me ju në vitin 2007 dhe kur të kam kërkuar që të më japësh një pendesë sa më të rëndë dhe ti më përgjigje nuk ka rëndësi të të japësh pendesë të madhe, më e rëndësishmja është që kujdesesh mos të biesh në mëkat, dhe të pendohesh për ato që ke bërë. Këtë e kam bërë dhe vazhdoj ta bëj me ndihmën e Zotit. Ruhem shumë prej mëkatit. Nuk kam gjë më frikë në këtë tokë ditë as natë se sa mëkatit. Për ta arritur këtë lutem shumë, dëgjoj Radio Marinë. Unë në Zembrën e Jezu Krishtit kam gjet pushim, urtësi, butësi, durim, drejtësi, paqe dhe bekim, strehim, mbrojtje. Kam gjet ilaçin e shpirtit dhe të trupit. Rri në Zembrën e Jezu Krishtit dhe nuk dal nga Zemra e tij. I kam premtuar të lumit Jezu Krisht sikur 20 vjeç të bëhesha unë ty nuk të lëshoj, nuk të harroj dhe nuk të mohoj. Vetëm në Zembrën e tij do të jetoj deri në vdekje. Vetëm Ai është në zembrën time. Pa vështirësi vuajtje dhe mundime nuk mund të jetojmë në këtë tokë. Bashkohem me Shën Palin që thotë pa dashuri s'ka asgjë. Pa dashuri nuk ka as fe.

Vitorja

Falënderoj Zotin për këtë dhuratë. Në kohën e kaluar na ka plasur zemra dhe na janë verbuar sytë, nuk kemi dëgjuar kabanat as s'kemi parë Kishë të hapur, kur ishim fëmijë iu gëzoheshim kabanave dhe të shkuarit në kishë. Pastaj u mbyllen të gjitha... Nuk kemi besuar se ne do t'ia arrijmë kësaj ditë të bardhë, por jemi lutur gjithmonë për fëmijët që ta gëzojnë këtë fat. Na përgjonin nëpër dritare, dyer, oborr dhe burri ju ka thënë një herë mos t'iu shoh më për këtë punë. Çka kemi hequr veç Zoti e di... E sot përmes valve të Radio Marisë çdo shtëpi u bë Kishë. Falënderojmë Zotin. Falënderoj Zotin Jezus për ty Don Prekë që të ka vendosur në këtë drejtim kaq të mrekullueshëm e kaq të vështirë. Bëftë Zoti të hapen të gjitha zemrat e secilit njeri përpara Fjalës së Tij që e shpallni përmes radio Marisë. Bëftë Zoti që të gjithë ta hapin zembrën dhe dorën që të ndihmojnë këtë vepër të filluar. Zoti ju rritë pushtetin dhe ju ruajt.

PRO CREDIT BANK

INTESA SANPAOLO BANK

NË ZVICËR

LLOGARIA NË **EURO 600388970102**

Kodi SWIFT: FEFAALFR

IBAN: AL45209516090000600388970102

LLOGARIA NË **EURO 1043631803**

Kodi SWIFT: USALALTR

IBAN: AL25208110080000001043631803

Duke telefonuar në numrin:

0900123411 dhuron 5 Franga

Në bankën **CREDIT SUISSE**

LLOGARIA NË **CHF 361173-10-1**

IBAN: CH1804835036117310001

Në bankën **KANTONALBANK**

LLOGARIA NË **CHF 90-105-8**

IBAN: CH8600763000115724145

LLOGARIA NË **LEK 600388970001**

Kodi SWIFT: FEFAALFR

IBAN: AL56209516090000600388970001

LLOGARIA NË **LEK 1043631801**

Kodi SWIFT: USALALTR

IBAN: AL 79208110080000001043631801